



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR NGRITJEN E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 25.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT

Për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

BAZA LIGJORE:

Neni 23, pika 1, germa "a", neni 95, neni 96, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve e të pranishmëve,

V Ë R E N:

Kodi Zgjedhor, në nenin 95, pika 1 përcakton se për numërimin e votave në rang ZAZ-je, me vendim të KZAZ-së, 10 ditë para datës së votimit caktohen Grupe të Numërimit të Votave.

Nr. 865 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019



Grupet e numërimit të votave përbëhen nga katër anëtarë, sipas përcaktimeve të:

- nenit 95, pika 2, ku parashikohet se: "një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar emërohet pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari i KZAZ-së, anëtar i tretë propozohet nga partitë politike të shumicës qeverisëse dhe anëtar i katërt emërohet pas propozimit të partive të opozitës që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve për ZAZ-të respektive, sipas procedurës së parashikuar në nenin 96 të këtij Kodi";
- nenit 96, pika 1, ku parashikohet se: "Partitë politike që kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve, përveç partive që propozojnë kryetarin dhe nënkryetarin e KZAZ-së, përcaktohen pas hedhjes së shortit në KQZ ndërmjet listës së partive politike të shumicës parlamentare dhe listës së partive politike të opozitës parlamentare të rregjistruara në zgjedhje dhe që kanë fituar jo më pak se dy mandate në zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë. Në çdo rast, pas hedhjes së shortit për çdo ZAZ, të drejtën e propozimit për dy anëtarë të Grupit të Numërimit të Votaveka një parti e shumicës parlamentare dhe një parti e opozitës parlamentare".

Në kushtet kur KQZ-ja, me vendimin nr. 657, datë 23.05.2019, vendosi rrëzimin e kërkesës së Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim për emërim të anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, rezultoi se nenet 95 dhe 96 të Kodit Zgjedhor, nuk mund të gjejnë zbatim për emërimin e anëtarëve të GNV-ve me anëtar të propozuar nga partitë e opozitës. Për rrjedhojë, Grupi i Numërimit të Votave në këtë situatë të re faktike dhe rregullatore mund të funksionojë me dy anëtarë të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila në ZAZ-të me numër çift ka propozuar Kryetarin e KZAZ-së, dhe në ZAZ-të me numër tek ka propozuar Zv.Kryetarin e KZAZ-së do të propozojë dy anëtarë të Grupeve të Numërimit të Votave sipas referimit ligjor të mëposhtëm:

- Një anëtar, bazuar në përcaktimet e nenit 95/2 të Kodit Zgjedhor "një anëtar emërohet pas propozimit të partisë politike, së cilës i përket kryetari i KZAZ-së, një anëtar pas propozimit të partisë që i përket nënkryetari";
- Një anëtar bazuar në përcaktimet e nenit 96, pika 1.1 "Nëse asnjë nga partitë politike që kanë të drejtë propozimi të anëtarit të tretë dhe të katërt nuk plotësojnë kushtin e përcaktuar nga ky nen, e drejta e propozimit i kalon, sipas rastit, partisë politike që propozon kryetarin ose zëvendëskryetarin e KZAZ-së brenda të njëjtit grupim politik".

Megjithatë, edhe pse ngritja e GNV-ve, me përbërjen aktuale në kufijtë minimal të përcaktuar nga neni 95/3 i Kodit Zgjedhor, mund të funksionojë me dy anëtarë, KQZ-ja çmon me rëndësi vlerësimin e kontekstit aktual në përputhje me udhëzimet e miratuara në zbatim të Kodit Zgjedhor, të cilat zërthejnë Kodin në nivelin më të pranueshëm të zbatueshmërisë. Më konkretisht, në mbështetje të nenit 95/5 KQZ-ja ka disiplinuar me udhëzim të veçantë, (Udhëzimi nr. 5, datë 22.04.2015), organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, ku ndër të tjera në nenin 3/5 të këtij udhëzimi ka përcaktuar se: "Në

Nr. 865 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019



rast se grupi i numërimit të votave funksionon me 2 anëtarë sipas përcaktimit të nenit 95/3 të Kodit Zgjedhor, detyrimisht procesi i numërimit të votave duhet të jetë i regjistruar me kamerat e teknologjisë mbështetëse të instaluara në ambjentet e VNV-së. Në rast se regjistrimi me kamera nuk funksionon për çfardo arsye....procesi ndërpritet deri në vënien në funksionim të teknologjisë mbështetëse, ose plotësimin e grupit të numërimit.

Nisur nga ky ky rregullim kuadër, KQZ-ja duke evidentuar faktin se në kushtet aktuale, GNV-ja do të ketë në çdo rast vetëm dy anëtarë si më sipër referuar, për të shmangur ndërprerjet e procesit në rast të mosfunksionimit të mjeteve të teknologjisë, referuar nenit 3 të udhëzimit nr.5, datë 22.04.2015, të sipërcituar vlerëson se KZAZ-ja mund të plotësojë grupin e numërit të votave me dy anëtarë të tjerë.

Duke qenë se në përbërjen aktuale, KQV-ja përvec anëtarëve të propozuar vetëm nga një subjekt zgjedhor ka edhe anëtarë edhe shtetas të emëruar kryesisht, KZAZ-ja, në mbështetje të nenit 95/ cakton dy anëtarë e tjerë duke përzgjedhur me short midis anëtarëve të emëruar kryesisht të KQV-së.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenet 23, pika 1, germa "a", 95 dhe 96 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008" Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" , i ndryshuar, dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 22.04.2015,

V E N D O S I:

1. Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019, do të përbëhen nga katër anëtarë, dy anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste, dhe dy anëtarë do të përzgjidhen nga KZAZ-ja me short nga anëtarët e emëruar kryesisht të KQV-ve të ZAZ-së.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Nr. 865 i Vendimit Data 25.06.2019 e Vendimit Ora 13:00 e Vendimit

Për ngritjen e Grupeve të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019

